

Relacion

Në Buxhetin Afatmesëm 2019-2021 të Bashkisë Tiranë, programi i Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit, është parashikuar zëri “Pajisje dhe orendi për kopshte dhe çerdhe”, i cili parashikon kompletimin me mobilije të disa kopshteve dhe çerdheve.

Për përcaktimin e çmimit njësi dhe më tej vlerës së preventivit, i jemi referuar çmimeve të tregut, të marra nga operatorët ekonomik të cilët operojnë në fushën e mobilijeve dhe pajisjeve arsimore.

Me marrjen e ofertave nga operatorët ekonomik është përcaktuar çmimi njësi për secilin zë.

Referuar nevojave për mobilimin të evidentuara nga Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, si dhe duke pasur parasysh fondin limit, është bërë hartimi i preventivit.

Specifikimet teknike për mobilimin e kopshteve dhe çerdheve janë bazuar në manualin “Specifikimet e Mobiljeve dhe të Pajisjeve laboratorike, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës”, mbi Shërbimet Arkitekturale/Inxhinierike për Përpunimin e Specifikimeve të Materialeve të ndërtimit nga specifikimet e pajisjeve dhe mobiljeve të çerdheve dhe kopshteve, si dhe në standartet e aplikuara nga Bashkia Tiranë ndër vite.

